



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1146/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekom i Kosovës Sh.a, me seli ne Prishtine, ndaj debitorit “ALM Group” Shpk, me seli ne fshatin Llapnasellë, Magjistrala Prishtinë – Ferizaj, ne Graçanicë, te cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. avokat nga Prishtina, me bazë juridik përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.294/23 datës 21.06.2023, me datën 05.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Posta dhe Telekom i Kosovës Sh.a, me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës– Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.294/23 i datës 21.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles e Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.294/23 dt.21.06.2023, ka Pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “ALM Group” Shpk, me seli ne fshatin Llapnasellë, Magjistrala Prishtinë – Ferizaj, ne Graçanicë, ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.88/17 dt.04.09.2017, i lejuar nga zyra përmbarimore e Përmbaruesit Arben Gashi, për territorin e Gjykatës Themelore ne Prishtinë dhe ka përfunduar ne tërësi përmbarimin ne këtë çështje përmbarimore. Po ashtu ka detyruar kreditorin Telekom i Kosovës sha, që debitorit, brenda afatit prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi ti paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 104€.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të aplikimit te gabuar te se drejtës procedurale, vërtetimit te gabuar te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështja të kthehet ne shkallë të parë.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Posta dhe Telekom i Kosovës Sh.a, me seli ne Prishtinë, me datën 04.09.2017, ka paraqitur propozim për përmbirim ndaj debitorit ALM Group” Shpk, me seli ne fshatin Llapnasellë, Magjistrala Prishtinë – Ferizaj, ne Graçanicë, ne bazë te dokumentit te besueshëm - Faturës 090306030149.

Përmbaruesi Privat Arben Gashi nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.88/2017 dt.04.09.2017, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te borxhit qe rrjedh nga fatura ti paguaj shumen prej 70.24 euro, me kamatë 8% duke filluar nga data kur kredia është bere e arritshme e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbarimit.

Kundër urdhrin përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 15.02.2023, me arsyetimin se lejimi i propozimit për përmbirim ne baze te faturës është i palejueshëm pasi nuk është i plotësuar kushti ligjor ne bazë i LPP sepse debitori nuk e ka pranuar asnjëherë këtë faturë. Kërkesa e kreditorit për borxhin nga fatura është parashkruar konform nenit 360 te LMD dhe kreditori kështu e ka humbur te drejtën ligjore për paraqitjen e propozimit për përmbirim. Debitori i referohet edhe dispozitave ligjore nga neni 47 par.1 dhe neni 18 par.1 te LPP e po ashtu edhe neni 110 par.1 te LPK. Shton se debitori asnjëherë nuk e ka pranuar faturën personalisht, pra fatura asnjëherë nuk i është dorëzuar debitorit, ne këtë rast i referohet aktvendimit CML nr.24/2017 dt.17.01.2018 te Gjykatës Supreme te Kosovës ne lidhje me faturat dhe pranimin dhe nënshkrimin e tyre nga debitori e ne kuptim te kësaj qe një faturë te konsiderohet e pranuar duhet qe përveç nënshkrimit edhe të jetë e vulosur. Propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhri përmbarimor te anulohet dhe të obligohet pala kreditore ti paguaj shpenzimet për prapësim.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 16.02.2023, se e konteston prapësimin e debitorit me arsyetimin se debitori ka shfrytëzuar numrin 044908608 për periudhën prej 01.11.2016-28.02.2017 dhe ka krijuar borxhin e kërkuar nga kreditori, provat ne prapësim duhet te dorëzohen me shkrim ndërsa debitori nuk ka ofruar asnjë provë në të cilën e mbështet prapësimin e tij, shton se ne rastin konkret nuk ka parashkrim siç pretendon debitori, debitori ka pranuar rregullisht faturat në baza mujore përmes postës elektronike. Propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin debitorit si te pajuar dhe te pabazuar.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.294/23 dt.21.06.2023, me të cilin e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit, ka anuluar urdhrin përmbarimor ndërsa ka përfunduar procedurën përmbarimore ne këtë çështje, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata arsyeton se pas shqyrtimit te pretendimeve te debitorit, kreditorit dhe shkresave gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri i lejuar për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore te parapara me nenin 29 dhe 37 te LPP. Dokumenti ne bazë te cilit është lejuar përmbarimi gjegjësisht fatura nr. 0903060149 dt.05.06.2017 nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm sepse ne rastin konkret është lëshuar ne mënyrë të njëanshme nga kreditori dhe e njëjta nuk është e pranuar nga debitori përkatësisht nuk përmban as nënshkrimin e as vulën e debitorit si edhe nuk ka dëshmi se është pranuar ne cilëndo formë nga debitori. Andaj duke qenë se nuk ka prova se debitori e ka pranuar faturën ne mënyrë te rregullt rezulton se fatura nuk mund te shërbej si dokument i besueshëm dhe se e njëjta nuk ka tipare te përmbarueshmerië ashtu qe si rrjedhojë e kësaj edhe urdhri përmbarimor i lejuar nga përmbaruesi privat duhet te anulohet. Gjykata ka shqyrtuar edhe çështjen e shpenzimeve te kërkuara nga debitori ashtu qe ka vendosur konform nenit 453 par.2 te LPK , ashtu që ka vendosur si ne dispozitivi te këtij aktvendimi.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Mbi bazën rrethanave dhe fakteve ne këtë lëndë përkitazi rastit konkret edhe kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Në vlerësim te çështjes rezulton se fatura mbi bazën e te cilës është lejuar përmbarimi nuk përmbush kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm sepse fillimisht ne shkresat e lendes nuk ka prova se kjo faturë është pranuar ne mënyrë te rregullt nga debitori, ashtu që të konsiderohet dokument i besueshëm dhe si e tillë te mund te ekzekutohet, pra e njëjta është lëshuar nga kreditori ne mënyrë te njëanshme, po ashtu e njëjta është e panënskruar apo e pavulosur nga debitori. Përkitazi kësaj çështje edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 29 par.3 te LPP-së i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar“*, ndërsa neni 37 i LPP-së, përcakton se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Përndryshe në procedurën përbarimore konfom parimit të rigorozetit formal, bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1146//23 me datë 05.03.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha